



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Seanca Plenare

Seanca nr.2004/01

Prishtinë,më 15 janar 2004,në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

PROCESVERBAL

Seancën e kryesoi Nexhat **DACI**,kryetar i Kuvendit, kurse bashkëkryesues ishte Fatmir **SEJDIU**,anëtar i Kryesisë.

Krytari konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 98 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Në seancën e mëparshme ishte miratuar rendi i ditës i kësaj seance,si vijon:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme;
2. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për transportin rrugor-nr.2003/32;
3. Shqyrtimi i vendimit të panelit lidhur me mocionin e koalicionit "Kthimi" në Ligjin për prokurimin publik-nr.2003/17;
4. Përgjigjet e ministrave pyetjeve të deputetëve dhe
5. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare të 22 janarit.

Në fillim të seancës,kryetari, në shenjë përkuftimi të pesëvjetorit të masakrës së Reçakut,të respektit,nderimi dhe dhimbjes për të masakruarit nga forcat serbe,i ftoi deputetët e Kuvendit të mbajnë **një minutë heshtje**.

Të gjithë të pranishmit,përveç deputetëve të koalicionit "Kthimi", u ngritën në këmbë dhe i nderuan të rënë në masakrën e Reçakut,me një minutë heshtje.

Kryetari kërkoi të procedohet sipas rendit të ditës,të miratuar në seancën e mëparshme.

Gani Koci,në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së,e pyeti Kryesinë dhe kryetarin e Kuvendit për vonesën e përfundimit të punëve në renovimin e sallës së Kuvendit,për mostransparencën,vlerësimin dhe përgjegjësit rreth tenderimit të saj.

Ai kërkoi të formohet një komision hetues parlamentar për t'i hulumtuar këto çështje.

Dragisha Krstoviq,në emër të Grupit Parlamentar “Kthimi”,shprehu pakënaqësinë për mbajtjen një minutë heshtje, për masakrën e Reçakut dhe rasteve të tjera, pa u konsultuar paraprakisht të gjithë kryetarët e grupeve parlamentare.

Ai kërkoi që pika e dytë e rendit të ditës të shtyhet për seancën tjetër.

Bujar Dugolli,në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së,kërkoi që deputetëve të këtij Kuvendi,që kanë qenë të kandiduar në zgjedhjet për Kuvendin e Serbisë,si dhe për sjelljet e tyre destruktive,t'u merret mandati i deputetit në Kuvendin e Kosovës.

1. Miratimi i procesverbali të seancës së mëparshme.

Procesverbali i seancës së mëparshme u miratua pa vërejtje.

2. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për transportin rrugor-nr.2003/32.

Kryetari i informoi deputetët e Kuvendit për raportet dhe për rekomandimet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit Funkcional për këtë p/ligj.Ai i hodhi në votë amendamentet e Komisionit për Transport dhe Telekomunikacion, veç e veç.

Kuvendi,me shumicë votash,i miratoi këto amendamente:1,2,45,6,7,8a,9,10,11 dhe 12. Ndërsa nuk i miratoi amendamentet:3 dhe 8b.

Kryetari e hodhi në votë P/ligjin në tërësi dhe rezultati ishte si vijon:

Për-----shumica;

Kundër-----12;

Abstenime-----0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi i Kosovës,me shumicë votash, e miratoi Ligjin për transportin rrugor-nr.2003/32.

3. Shqyrtimi i vendimit të paneli lidhur me mocionin e koalicionit “Kthimi” në Ligjin për prokurimin publik-nr.2003/17.

Kryetari i informoi deputetët lidhur me vendimin e panelit që i kishte propozuar Kuvendit për miratim.

Bujar Dugolli, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, kërkoi nga Qeveria që për anëtarë të panelit t’i caktojë profesionistët e fushave përkatëse, kurse nga UNMIK-u të mos i marrë për bazë shantazhet dhe veprimet destruktive të disa deputetëve të koalicionit “Kthimi”, për mosshpalljen e ligjeve që i miraton Kuvendi.

Hydajet Hyseni bëri vërejtje të natyrës formalo-juridike, me rastin e formimit të panelit, ngase anëtar të tij kishin qenë një person nga kundërshtuesi i ligjit që nuk ishte deputet i koalicionit “Kthimi” dhe një zyrtar tjetër nga propozuesi i ligjit që nuk ishte anëtar i Qeverisë. Këta persona, shtoi ai, nuk e kanë të drejtën të bëjnë amendamente në ligj dhe t’i propozojnë Kuvendit për miratim.

Ai propozoi që Kuvendi ta miratojë vetëm amendamentin 3, nenin 40.3a dhe b, kurse amendamentet e tjera të mos i miratojë.

Kryetari tha se vendimi i panelit duhet të votohet në tërësi dhe e hodhi atë në votë dhe rezultati ishte si vijon:

Për-----shumica;
Kundër-----29;
Abstenime-----0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi i Kosovës e miratoi vendimin e panelit në Ligjin për prokurimin publik-nr.2003/17.

Pjesën tjetër të seancës e drejtoi **Fatmir Sejdiu**, anëtar i Kryesisë.

4. Përgjigjet e ministrave pyetjeve të deputetëve.

Ministrja Resmije Mumxhiu iu përgjigj pyetjeve të deputetit **Ismajl Kurteshi** lidhur me funksionimin e ambulancave shëndetësore nëpër vendbanimet rurale të komunës së Gjilanit dhe pyetjes së deputetit **Ramadan Kelmendi** lidhur me mbylljen e repartit të kirurgjisë në Mitrovicë.

5. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare të 22 janarit.

Kryesia ia kishte propozuar Kuvendit rendin e ditës për seancën plenare të 22 janarit si vijon:

1. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për Odën Ekonomike të Kosovës-nr.2003/33;
3. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për tregti me naftë dhe me derivatet e saj-nr.2003/33;
4. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për kinematografinë-nr.2003/36.

Tomë Hajdaraj propozoi që P/ligji për materialin fidanor të vihët në rend dite të seancës së ardhshme.

Lirak Çelaj kërkoi që të mbrohet imuniteti i deputetëve të Kuvendit dhe shprehu pakënaqësi për sjelljen jokorrekte të disa policëve të SHPK-së,nda tij më 28 dhjetor 2003.

Fatmir Rexhepi kërkoi që shqyrtimi i dytë i P/ligjit për Odën Ekonomike të Kosovës të shtyhet për ndonjë seancë tjetër,ngase pas dëgjimit publik lidhur me këtë p/ligj,Komisioni për Financa dhe Ekonomi nuk do të mund ta përgatitë raportin për seancën e ardhshme.

Edita Tahiri propozoi që Kuvendi,në njërën nga seancat e radhës,ta shqyrtojë gjendjen në telekomunikacionin e Kosovës.

Ljubomir Stanojković propozoi që Kuvendi,në njërën nga seancat e radhës,ta shqyrtojë procesin e privatizimit në Kosovë.

Xhavit Haliti propozoi të ftohet përfaqësuesi i policisë së UNMIK-ut dhe t'u shpjegojë deputetëve të Kuvendit lidhur me akuzat e z. Hilkeri se shqiptarët kanë vrarë fëmijë serbë në Kosovë.

Kryesuesi tha se Kryesia do t'i shqyrtojë të gjitha këto kërkesa dhe propozime.

Kuvendi e miratoi rendin e ditës për seancën plenare të 22 janarit,në formën e propozuar nga Kryesia.

Kryesuesi e deklaroi seancën të mbyllur në orën 11:30 minuta.

Sekretaria e Kuvendit

Kryetari i Kuvendi të Kosovës

Akademik Nexhat DACI